REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr.Br. 734/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 734/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "Arta Tex Group" SH.P.K. - Pejë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi me uniforma për stafin korrektues" me nr. të prokurimit: "33600-20-4032-1-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Arta Tex Group" SH.P.K. - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me uniforma për stafin korrektues" me nr. të prokurimit: "33600-20-4032-1-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Shërbimi Korrektues i Kosovës.

II.VËRTETOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi me uniforma për stafin korrektues" me nr. të prokurimit: "33600-20-4032-1-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Korrektues i Kosovës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Arta Tex Group" SH.P.K. – Pejë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI . Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Arta Tex Group" SH.P.K. - Pejë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.09.2020 me nr. 734/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi me uniforma për stafin korrektues" me nr. të prokurimit: "33600-20-4032-1-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 10, 27, 27/A, 28, 68, 108/A dhe nenin 109 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 08.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Operatori ekonomik ankues "Arta Tex Group" SH.P.K., ka disa pretendime, ku ndër to janë se tenderi është dashur të ndahet në Lote, specifikimet teknike janë diskriminuese dhe nuk janë në përputhje me qëllimin e prokurimit, është kërkuar që të eliminohet kërkesa që prodhuesi të jetë i certifikuar me ISO 14001:2015, nuk është bërë pezullimi i aktivitetit të prokurimit konform nenit 108/A, andaj kërkon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet dhe të ritenderohet.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa për rishqyrtim është bërë më datë: 16.09.2020, ndërsa Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim është bërë më datë: 21.09.2020, po të njëjtën ditë është bërë

edhe hapja e ofertave, ashtu siç është paraparë në dosjen e tenderit.

Në nenin 8.1.1, konkretisht në pikën II, Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, thuhet: Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do të vazhdoj më tutje me procedurën e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ka vazhduar me hapjen e ofertave, si dhe komisioni vlerësues më datë 30.09.2020, e ka bërë vlerësimin e ofertave ku rekomandon menaxherin e prokurimit që të anulohet ky aktivitet i prokurimit, për më tepër shiko më poshtë:

"Komisioni i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave sipas vendimit me nr. të prot: 0834 i datës 22.09.2020 pas vlerësimit të ofertave dhe ekzaminimit të mostrave ka ardhur në përfundim se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme. Komisioni rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet pasi nuk kemi oferta të përgjegjshme."

Ky vlerësim me rekomandim është aprovuar nga menaxheri i prokurimit ku është nënshkruar më datë 30.09.2020, dhe nuk ka vazhduar më me procedura të mëtutjeshme për shkak të ankesës së parashtruat nga OE në OSHP.

Andaj duke pasur parasysh ku kërkesë kryesore e OE ankues ka qenë që të anulohet aktiviteti i prokurimit, si dhe vlerësimit të komisionit vlerësues ku konstaton që duhet të anulohet ky aktivitet i prokurimit, konstatoj se është plotësuar kërkesa kryesore e OE ankues, ku është kërkuar të anulohet ky aktivitet i prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lart përmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 12.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Operatori ekonomik ankues "Arta Tex Group" SH.P.K., ka disa pretendime, ku ndër to janë se tenderi është dashur të ndahet në Lote, specifikimet teknike janë diskriminuese dhe nuk janë në përputhje me qëllimin e prokurimit, është kërkuar që të eliminohet kërkesa që prodhuesi të jetë i certifikuar me ISO 14001:2015, nuk është bërë pezullimi i aktivitetit të prokurimit konform nenit 108/A, andaj kërkon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet dhe të ritenderohet.

Paneli shqyrtues sqaron se kërkesa për rishqyrtim është bërë më datë: 16.09.2020, ndërsa Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim është bërë më datë: 21.09.2020, po të njëjtën ditë është bërë edhe hapja e ofertave, ashtu siç është paraparë në dosjen e tenderit.

Në nenin 8.1.1, konkretisht në pikën II, Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, thuhet: Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do të vazhdoj më tutje me procedurën e prokurimit. Autoriteti Kontraktues ka vazhduar me hapjen e ofertave, si dhe komisioni vlerësues më datë 30.09.2020, e ka bërë vlerësimin e ofertave ku rekomandon menaxherin e prokurimit që të anulohet ky aktivitet i prokurimit: "Komisioni i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave sipas vendimit me nr. të prot: 0834 i datës 22.09.2020 pas vlerësimit të ofertave dhe ekzaminimit të mostrave ka ardhur në përfundim se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme. Komisioni rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet pasi nuk kemi oferta të përgjegjshme."

Ky vlerësim me rekomandim është aprovuar nga menaxheri i prokurimit ku është nënshkruar më datë 30.09.2020, dhe nuk ka vazhduar më me procedura të mëtutjeshme për shkak të ankesës së parashtruar nga OE në OSHP.

Andaj duke pasur që kërkesë kryesore e OE ankues ka qenë që të anulohet aktiviteti i prokurimit, si dhe vlerësimin e komisionit vlerësues ku konstaton që duhet të anulohet ky aktivitet i prokurimit, paneli shqyrtues vlerëson se është plotësuar kërkesa kryesore e OE ankues, që të anulohet ky aktivitet i prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Blerim QINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Shërbimi Korrektues i Kosovës

1x1 OE - "Arta Tex Group" SH.P.K. - Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.